



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar”.
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj - Ministre e Drejtësisë

Kujtim Luli –prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Enio Haxhimihali- drejtor i Kabinetit tek Avokati i Popullit

Sotiraq Nushi – ndihmëskomisioner tek Avokati i Popullit

Nita Shala- eksperte vendase, Misioni EURALIUS

Brunilda Jani- eksperte në Departamentin i Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane

(OPDAT)

Amarda Sellaj- eksperte në Departamentin i Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane

(OPDAT)

Madalena Koja- Juriste pranë departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë ne Kryeministri

Alma Dino - përfaqësuese nga departamenti Juridik i Agjencisë së Prokurimit Publik

Xhoana Licka -përfaqësuese nga Agjencia e Prokurimit Publik

Albana Shkurta- zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shktylla- specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ardiana Jaku –zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj- nëndrejtoe e Shërbimit Social Shtetëror

Antoneta Njehrrëna- drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo- përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj -drejtore e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është pranishëm për të vazhduar me çështjet e rendit të ditës.

Sot për shqyrtim kemi 5 projektligje.

Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”. Komisioni ligjeve është komision përgjegjës.

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar.

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar”. Komisioni i ligjeve është komision përgjegjës.

Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi.

Pa humbur kohë fillojmë diskutimet për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”. Relator është kolegu Adnor Shameti. Të pranishme në komision kemi ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj. Prezent në komision kemi zotin Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga Institucioni i Avokatit të Popullit prezent kemi zotin Enio Haxhimihali, drejtor i Kabinetit, dhe zotin Sotiraq Nushi, ndihmëskomisioner. Nga misioni ndërkombëtar EURALIUS kemi prezent zonjën Nita Shala, eksperte vendase. Nga Departamenti i Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT) prezent kemi zonjën Brunilda Jani, eksperte, dhe zonjën Amarda Sellaj, eksperte.

Zonja Ministre, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Prezenca juaj sot në komision tregon rëndësinë që ka ky ndryshim, i cili propozohet në ligjin për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

Faleminderit për prezencën tuaj sot!

Fjala për ju, për të bërë një parashtrim të këtij ndryshimi ligjor që propozohet për kolegët e komisionit për opinionin publik dhe pastaj do t'ia kaloj fjalën relatorit të këtij projektligji, kolegut zotit Shameti.

Fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lufta kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit ka qenë e mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë dhe një nga detyrimet kryesore që rrjedhin nga procesi për integrimin europian. Kjo luftë është ashpërsuar, ndërkohë masat e qeverisë janë bërë edhe më efikase gjatë vitit të fundit, veçanërisht me nisjen e operacionit “Forca e ligjit”.

Një numër i konsiderueshëm grupesh kriminale janë goditur dhe pjesëtarët e tyre ndodhen pas hekurave të burgjeve, në pritje të gjyqimit. Sa më të forta bëhen masat që ne ndërmarrim dhe sa më të dukshme bëhen rezultatet, aq më i sofistikuar përpiqet të bëhet krimi, për të vijuar aktivitetin e paligjshëm.

Nga puna operative e strukturave të sigurisë në burgje, por edhe nga strukturat e Policisë së Shtetit është konstatuar se elementët kriminalë, ndonëse të izoluar në burgje, kanë tendencën të ruajnë lidhjet me bashkëpunëtorët jashtë, për të vijuar aktivitetin kriminal. Në kontekstin e forcimit të masave për luftën pa kompromis ndaj krimit të organizuar dhe veçanërisht të izolimit sa më mirë të elementeve kriminalë, që tashmë janë në burgjet tona, vjen dhe propozimi i projektligjit që po diskutojmë sot.

Qëllimi i këtij projektligji është rritja e masave të sigurisë dhe kufizimi i të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve për raste të veçanta që lidhen me krimin e organizuar, duke iu nënshtuar një regjimi të posaçëm brenda regjimit të sigurisë së lartë. Masat e ndërmarra në kuadër të këtij regjimi janë të ngjashme me masat e parashikuara nga legjislacioni italian, i quajtur “41Bis” “Për trajtimin e të dënuarve”, që janë ndërmarrë në atë kohë edhe nga qeveria Italiane. Ky nen, pra “41Bis”, që është për trajtimin specifik dhe për kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të të dënuarve, në atë kohë që është miratuar në Itali, ka kaluar disa herë për miratim si në Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe është konsideruar në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me gjithë legjislacionin ndërkombëtar që bën fjalë për trajtimin e të dënuarve në institucionin penitenciar. Sipas kësaj jurisprudence këto masa janë të nevojshme në rast se cenohet rendi dhe siguria në institucion, si dhe për të mbajtur nën kontroll rrezikshmërinë objektive të të dënuarve. Në të gjitha rastet kur këto masa përdoren abuzivisht dhe në mënyrë arbitrare përbën motiv për t'iu drejtuar Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ne i jemi referuar modelit italian, pasi gjykojmë se ky model ka dhënë rezultate konkrete dhe është i mundshëm të aplikohet edhe në Shqipëri, madje nga partnerët ndërkombëtarë, përfshirë këtu Prokurorinë e Antimafies Italiane dhe kreun e delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri, është konsideruar se në momentin në të cilën ndodhet Shqipëria është shumë e rëndësishme që të aplikohet ky regjim i posaçëm në institucionet penitenciare.

Mënyra e zbatimit të këtyre masave në realitetin shqiptar është pak më ndryshe, nga mënyra e zbatimit në praktikë në Itali. Por ashtu siç është parashikuar në projektligj, zbatimi i këtyre masave është në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe ajo që është më e rëndësishme në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas këtyre orientimeve kufizimet e të drejtave duhet të ndërmerren vetëm në situata emergjente dhe të kenë një kohëzgjatje të kufizuar, pra të përcaktuar, ku sipas së cilës mund të rivlerësohen kushtet dhe kriteret për zbatimin e këtij regjimi të posaçëm.

Në kushtet e realitetit shqiptar, nisur edhe nga detyrat që Bashkimi European i ka ngarkuar Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, ky fenomen përbën një trajtim për një situatë emergjente. Pra nëse një person do të arrestohet dhe do të gjykohet për këto vepra penale të parashikuara edhe në shtesën që i është bërë nenit 13/1, ku është përcaktuar: “Nëse një person do të arrestohet ose do të gjykohet për këto vepra penale, ai duhet të vendoset në një regjim të posaçëm me kufizim të të drejtave me qëllim për të parandaluar: kontaktet me organizatën kriminale apo grupin kriminal ku bën pjesë, por edhe me organizata të tjera aleate, konflikte të mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë si dhe ndërveprimin me të burgosurit apo me të paraburgosurit e tjerë që i përkasin të njëjtës organizatë apo organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë”. Kjo periudhë e përcaktuar në projektpropozimin e nenit 13/1 dhe nuk mund të jetë më e gjatë se një vit. Në përputhje me orientimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut është përcaktuar e drejta e të dënuarit apo e paraburgosurit që t’i drejtohet ministrit të Drejtësisë për një rivlerësim të kushteve për vazhdimësinë e këtij regjimi të posaçëm. Në projektligj janë parashikuar edhe kriteret se ku duhet të bazohet vendimi i ministrit të Drejtësisë për rivlerësimin e kësaj situatë. Pas rivlerësimit të kushteve dhe urdhrin të ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e këtij regjimi të posaçëm për një periudhë tjetër 1 vjeçare, i dënuari, i paraburgosuri ose avokati mbrojtës kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, me qëllim që t’i sigurohen parimet e procesit të rregullt ligjor.

Caktimin e subjekteve që trajtohen me modelin e ri e bën neni 28 i Kodit Penal, ku trajton forma të veçanta të bashkëpunimit, duke radhitur grupin e strukturuar kriminal,

organizatën kriminale, bandën e armatosur dhe organizatat terroriste. Sipas paragrafit 5 të nenit 28, të Kodit Penal “Krijimi dhe pjesëmarrja në organizata kriminale, organizata terroriste, banda të armatosura dhe grupe të strukturuar kriminale, cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës posaçme të Kodit Penal”. Ndërsa sipas paragrafit 6 të këtij neni “Anëtarët e organizatës kriminale apo terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal, janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre, në përmbushje të veprimtarisë kriminale”. Duke u nisur nga ky përcaktim të nenit 28 të Kodit Penal, legjislatori ka përcaktuar gjithashtu vendosjen e subjekteve të krimit të organizuar që janë në një regjim të sigurisë së lartë që vendosen me vendim gjykate. Kjo është arsyeja përse është lënë, edhe në projektpropozimin, që gjykata të përcaktojë në bazë të dispozitave të parashikuara që në hyrje të shtesës së nenit 13, se cilat do të jenë subjektet që janë përfshirë në ato vepra penale, të akuzuar apo të dënuar, të cilët do të vendosen në një regjim të posaçëm ose në një regjim me të drejta më të kufizuara brenda regjimit të sigurisë së lartë. Sipas këtij parashikimi vendosja e subjektit të krimit të organizuar në burgun e sigurisë së lartë vendoset direkt nga gjykata, ndërsa për të dënuarit e tjerë mund të lihet në dorë të gjykatës nëse duhet të vendosen këta të dënuar në burgun e sigurisë së lartë ose jo. Për këtë kategori të dytë legjislacioni ka parashikuar në nenin 13 të ligjit “Për të drejtat e trajtimit të dënuarve me burgimin dhe të paraburgosurve”, kur gjykata nuk është shprehur me vendim për vendin ku do të vuhet dënimi, këtu është rasti që dënimi do të vuhet në burg të sigurisë së lartë, atëherë kjo bëhet me kërkesë të prokurorit te kjo gjykatë.

Nisur nga ky parashikim, edhe në bazë të paragrafit 3 të nenit 13, të këtij ligji dhe në kuadër të situatës emergjente që po kalon lufta ndaj krimit të organizuar në Shqipëri, kemi propozuar këtë amendament të projektligjit me qëllim kufizimin e të drejtave të të dënuarve që janë pjesë e krimit të organizuar. Për këtë arsye është menduar të shtohet neni 13/1, për të përcaktuar më qartë dhe për të vendosur të gjitha kriteret me qëllim që të jetë e lehtëzbatueshme për të gjithë ata të dënuar ose të paraburgosur që karakterizohen brenda këtyre veprave penale, pra kur dyshohen për këto vepra penale ose kur dënohen nga gjykata.

Në paragrafin e parë është bërë një përcaktim i saktë i neneve në të cilën duhet të zbatohet ky regjim i posaçëm dhe këto nene dënojnë jo vetëm krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bande të armatosur ose grup të strukturuar kriminal, por edhe veprat penale të kryera nga anëtarët e krimit të organizuar në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të veprimtarisë kriminale.

Po në këtë paragraf të parë të propozimit janë parashikuar një sërë masash që duhet të ndërmerren ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve që hetohen apo gjykohen për vepra penale.

Në këtë regjim kemi menduar të vendosim të dënuarit me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për shkak të veprave penale të kryera dhe për rrezikshmërinë që ata kanë. Zbatimi i këtij regjimi, që në fillim të ngritjes së akuzës për këto vepra penale, lidhet ngushtë me politikën penale që duhet të ndjekë qeveria në kuadër të parandalimit të krimit të organizuar. Nevoja për të siguruar rendin publik jashtë institucionit, por edhe për të shmangur trazirat dhe revoltat brenda në institucion nxisin nevojën për të parandaluar pikërisht ato që përmenda, të cilat janë kryesisht kontaktet me botën jashtë, përfshirë këtu edhe organizatat kriminale ku kanë bërë pjesë apo organizatat e tjera.

Kjo ishte një paraqitje e shkurtër për sa i përket propozimit, i cili ka gjithmonë si qëllim kryesor vetëm parandalimin e krimit të organizuar dhe për të mundësuar pikërisht atë luftë që Policia e Shtetit bën për kapjen e personave të përfshirë në këto grupe brenda institucioneve penitenciare, por gjithashtu të kemi mundësinë të mos lejojmë që këto grupe ta vazhdojnë aktivitetin kriminal edhe brenda institucioneve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka relatori, kolegu Adnor Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Sot në Komisionin e Ligjeve është paraqitur një iniciativë ligjore e Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, që ka lidhje me një ndryshim në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”.

Lajmi i mirë është se nën dritën e strategjisë kundër krimit të organizuar, të paraqitur nga qeveria, si dhe masave për parandalimin e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, kjo nismë është për t’u vlerësuar, ndaj në parim, i ftoj të gjithë anëtarët e këtij komisioni, që ta mbështesin e ta votojnë këtë nismë ligjore.

Nga ana tjetër, e gjej me vend të sqaroj si anëtarët e komisionit ashtu edhe opinionin publik, se në vetvete, paraqitja e një nisme të tillë, e cila kërkon kufizimin e disa të drejtave kushtetuese për një grup të caktuar, specifikisht të posaçëm të paraburgosurish apo të dënuarish, çon në kufizimin e të drejtave kushtetuese, kufizimi i të cilave përballë balancës që ekziston midis ruajtjes së sigurisë publike dhe integritetit të vendit duhet të realizohet si i tillë.

Megjithatë, në pjesën e kalimit nën për nën apo paragraf për paragraf, do të sugjeroja të bëhej në një seancë tjetër. Unë mendoj ta marrim në analizë të plotë të gjithë rregullimin ligjor kombëtar, por edhe ndërkombëtar, që ka të bëjë me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, instrument ky i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, Konventa për Parandalimin e Torturës, pasi ekziston një vijë e hollë ndarëse midis shkeljes së të drejtave kushtetuese nga

njëra anë, dhe nga ana tjetër respektimin e këtyre të drejtave, të parashikuara në aktet ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe Shqipëria.

Këto elemente, që duhet të shikohen me shumë vëmendje, i takojnë si rrethit të subjekteve që do të trajtohen nga ky ndryshim në ligj, ku duhet të dalë e qartë se bëhet fjalë për subjekte të posaçme, për krerët e organizatave kriminale, pasi në vetvete, neni 41 bis i parashikuar nga legjislacioni italian apo edhe një dispozitë e parashikuar në legjislacionin holandez, që sot janë dy të vetmit që operojnë në Europë, duhet të jenë të tilla, që të mund të parandalohet veprimtaria e krerëve të organizatave kriminale, jo që kjo të ushtrohet kjo për një rreth të gjerë subjektësh.

Është e domosdoshme të sqarohet roli i gjykatës në autoritetin administrativ të ministrit të Drejtësisë që nga momenti i kryerjes së urdhrit për përfshirjen në këtë rreth personash. Nga ana tjetër duhet parë kohëzgjatja e këtij regjimi të posaçëm për këtë grup të posaçëm subjektësh të posaçme, sikurse edhe e drejta e ankimit ndaj këtij urdhri administrativ në gjykatë, apo elementë të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me këto çështje.

Në cilësinë e relatorit të këtij projektligji, duke ju ftuar që sot të bëjmë miratimin në parim të këtij projektligji, do të kërkoja që, në ditët në vijim, para se të kalohet në seancë plenare dhe para se ta votojmë në detaje e nen për nen këtë nismë ligjore, të thërrisim edhe një tryezë të përbashkët me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara, të cilët janë sot pjesëmarrës në këtë seancë të Komisionit të Ligjeve. Kjo me qëllim që kur të bëhet votimi nen për nen i projektligjit, të kemi ezauruar çdo diskutim, çdo çështje të debatueshme midis personave pjesëmarrës, me qëllim që të vijmë sa më në konformitet me draftin përfundimtar që do t'i paraqitet komisionit në votimin nen për nen, me gjuhën që ka Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa për Parandalimin e Torturës, Praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, me ato raste që ka pasur qoftë me Italinë apo Holandën, me qëllim që në të ardhmen të mund të parandalojmë çdo lloj rasti të Shqipërisë në Strasburg, në lidhje me zbatimin në praktikë të këtyre ndryshimeve ligjore.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Qefalia ka kërkuar fjalën për pyetje.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, ashtu si dhe relatori, dua ta përgëzoj ministren e Drejtësisë për nismën që ka ndërmarrë, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e masave të sigurisë. Vetëm duke e pasur në kohezion të plotë, mendoj se në tërësi ky ligj duhet pasur shumë në vëmendje, pasi bie ndesh

me disa nga konventat universale të të drejtave të njeriut, se ka të bëjë me kufizimin e ajrosjes, regjistrimin e bisedave familjare apo kontrollin e korrespondencës.

E bëra këtë parashtrësë, zonja Ministre, për t'ju drejtuar me një pyetje: a keni bërë ju ndonjë studim, për të parë se sa është numri i këtyre individëve, të cilët akuzohen për veprat e parashikuara në ligj apo që momentalisht janë të paraburgosur?

Së dyti, a mendoni se vendosja në një regjim të posaçëm, të veçantë, siç parashikohet në ligj, rrit numrin e individëve, bëhet apriori duke u kufizuar vetëm te veprat e jo duke marrë indicie nga prokurori, kjo do të ndikojë në rritjen e këtij numri? Pyetjet e tjera i kam kur të kalojmë në shqyrtimin nen për nen, por do të doja një informacion për këto dy pyetje.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Falënderoj relatorin dhe zotin Qefalia për pyetjet!

Para se të kaloj në përgjigjet e pyetjeve të zotit Qefalia, dua të bëj një sqarim. Duke mbajtur në konsideratë vendimet e Gjykatës Europiane kundër Italisë lidhur me rregullat e përcaktuara nga ligji italian, neni 41, grupi i punës, i ngritur në Ministrinë e Drejtësisë, është treguar shumë i kujdesshëm, me qëllim që ato problematika që prekin ose janë në vijën e hollë të prekjës së të drejtave konventore të këtyre personave, të cilët ndodhen në regjim të posaçëm ose në një regjim të kufizuar të të drejtave brenda sigurisë së lartë. Ne kemi tentuar që të bëjmë të mundur të gjitha këto raste, që Gjykata Europiane i ka diskutuar nëse mund të përbëjnë një cenim apo jo, duke i parashikuar në rregullat e propozuara të nenit 13, paragrafi 1. Kjo do të thotë që, nëse Gjykata Europiane ka menduar ose ka diskutuar në vendimet e saj që një nga të drejtat e kufizuara për këtë kategori të dënuarish ose të paraburgosurish mund të përbëjnë një cenim të neneve konventore, siç është neni 5, apo edhe rregulla minimale të burgjeve, pikërisht kjo është mbajtur në konsideratë nga grupi i punës, që të reflektohet në parashikimin e propozuar në nenin 13/1 të ligji për trajtimet e të dënuarve.

Gjithashtu, dua të theksoj se pikërisht grupi i punës, i cili është i mbështetur edhe nga ambasada britanike, edhe nga Këshilli i Europës, po rishikon të gjithë paketën ligjore, që ka të bëjë me sistemin penitenciar apo me ekzekutimin e vendimeve penale. Por duke e mbajtur në konsideratë një situatë, që kërkon një zgjidhje pak më të shpejtë se sa rishikimi i të gjithë paketës ligjore, menduam ta bënim këtë amendament. Gjithashtu, edhe nga informacionet që i vijnë Ministrisë së Drejtësisë nga strukturat dhe organet ligjzbatuese, duhet me doemos që për këtë kategori personash që janë pjesë e grupeve, organizatave kriminale apo edhe atyre me karakter terrorist, të ketë kufizime të drejtash brenda regjimit të sigurisë së lartë, pa shtuar një

regjim të ri dhe pa prezantuar një regjim të ri në sistemin penitenciar. Nëse do të krahasojmë parashikimet e nenit 41 me atë çfarë kemi bërë në nenin 13, paragrafi 1, nuk i është lënë në diskrecion vendimi i ministrit të Drejtësisë, ashtu siç ka bërë legjislacioni italian, për të përcaktuar se cilat nga kategoritë ose kush nga personat do të përfshihet në këtë regjim të kufizuar brenda sigurisë së lartë, por është lënë me vendim gjykate, duke prezantuar, gjithashtu, edhe kategorinë e veprave penale që në hyrje të nenit 13, paragrafi 1, me qëllim që ministri i Drejtësisë të mos ketë diskrecion për të përcaktuar se cili nga këto subjekte do të përfshihet në këtë regjim të posaçëm, duke i dhënë një garanci më tepër mënyrës së garantimit ose mjeteve të ankimit të subjekteve, që do të jenë pjesë e këtij regjimi. Gjithashtu, është lënë një garanci dhe një afat, sepse edhe Gjykata Europiane këtë ka ngritur, pra këta persona, të cilët kanë një rrezikshmëri të përcaktuar, kanë një rrezikshmëri të lartë për shkak të veprës apo për shkak të rrezikshmërisë së tyre shoqërore duhet vendosur një kufizim në kohë, i përcaktuar në ligj. Kjo është arsyeja që në nenin 13, paragrafi 1, kemi përcaktuar afatin 12-vjeçar, ndërkohë Italia e ka me një afat 4-vjeçar dhe më pas 2-vjeçar.

Ne e kemi lënë një vit, duke i dhënë mundësinë çdo personi të dënuar ose të paraburgosur, që është brenda këtij regjimi, t'i drejtohet ministrit të Drejtësisë për të rishikuar nëse vazhdon të jetë në të njëjtat kushte për të qëndruar në këtë regjim të posaçëm, apo jo. Ministri i Drejtësisë nuk mundet që menjëherë, në mënyrë diskrecionare, të vendosë nëse ky person do të vazhdojë të qëndrojë në regjim të posaçëm apo jo, por merr informacion nga prokuroria, nga Ministria e Brendshme dhe nga të gjitha organet e tjera ligjzbatuese ose me karakter informativ, në mënyrë që të marrë një vendim sa më plotë. Përsëri në fund këtij personi të dënuar ose të paraburgosur i jepet e drejta e ankimit në Gjykatën e Lartë, duke ruajtur të gjitha garancitë, edhe të nenit 5, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, edhe të nenit 6 që ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor. Kjo bëhet për faktin që ne nuk përbëjmë shkelje të të drejtave konventore apo të drejtave kushtetuese. Pa diskutim ne kemi ruajtur proporcionalitetin e rrezikshmërisë me masat e kufizuara.

Për sa i përket pyetjes nëse Ministria e Drejtësisë ka bërë një studim të tillë, apo jo, që në momentin e parë që u propozuan të merreshin këto masa në projektligj u bë një studim për të parë se cilat ishin elementët apo subjektet, që akuzohen apo janë të dënuar për vepra penale të tilla. Gjithashtu, është nxjerrë edhe numri dhe na ka rezultuar se numri është rreth 1520 dhe kjo është arsyeja për të cilën ne kemi vendosur që në bazë të këtyre neneve, të cilat parashikohen nga pjesa e posaçme e Kodi Penal, këto subjekte të përfshihen në këtë regjim të posaçëm.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Po, zoti Braho.

Më pas fjalën e ka zonja Bushka.

Spartak Braho - Duke mbështetur dhe vlerësuar propozimet që bëri relatori, gjatë shqyrtimit nen për nen, paraprakisht ne mbyllëm edhe një seancë konsultimi, dëgjimi, shkëmbim përvojash dhe eksperiencash edhe me struktura të tjera, që rezultuan të domosdoshme. A ka ndonjë vërejtje nga Avokati i Popullit për këto ndryshime?

Së dyti, zonja Ministre, ju referuat se është marrë përvoja e ligjit italian. Shumë mirë keni bërë që keni marrë përvojën e ligjit italian, por nuk e kuptoj pse i jeni shmangur? Në qoftë se ata e kanë 2 vjet, atëherë të qëndrojnë 2 vjet. Në qoftë se ata kanë kërkesa të tjera, përvoja e ligjit penal dhe procedural italian është një garanci e mirë, sepse është një përvojë që vjen nga i gjithë zbatimi i këtij ligji në Itali. Megjithatë, kjo është një çështje që ju e keni çmuar, por më duket si një lloj lëvizjeje nga boshti duke pasur parasysh se në paragrafin e fundit, ju lutem specialistëve të më ndjekin me kujdes, thuhet: “Nëse kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga ana e gjykatës, ministri i Drejtësisë në rast se do të urdhërojë një vendim të ri, duhet të mbajë parasysh përcaktimet e bëra në vendimin e gjykatës, duke shtuar elemente të reja ose që nuk janë të vlerësuar nga ana e saj”. Kjo e kompromenton frazën. Nëse ka vendime gjyqate, nuk mund të shtosh elemente të tjera, sepse edhe ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë. Kështu që shikojeni me kujdes fjalinë “duke shtuar elemente të reja ose që nuk janë vlerësuar nga ana e saj”

Së fundi, këto shtesa në ligj kanë nevojë për rregullime me akte nënligjore, të cilat nuk janë parashikuar. Veçanërisht Drejtoria e Burgjeve ka peshën kryesore në zbatimin e tyre, mbase duhet një dispozitë që brenda kaq kohësh Ministria e Drejtësisë nxjerr akte nënligjore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Para se t’ia kaloj fjalën ministres së Drejtësisë për të dhënë përgjigjet në lidhje me pyetjet që shtroi zoti Braho, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit se sot kemi të pranishëm në këtë mbledhje përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, të institucionit të Avokatit të Popullit, të misionit EURALIUS dhe OPDAT-it. Deri tani Prokuroria e Përgjithshme ka sjellë materiale, të cilat i keni mbi tryezën e punës suaj, misioni ndërkombëtar EURALIUS ka sjellë një material dhe do të vijë edhe me propozime konkrete në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, si edhe institucioni i Avokatit të Popullit, i cili ka sjellë disa rekomandime në lidhje me projektligjin. Gjithsesi jemi në pritje dhe të opinioneve të tjera që mund të vijë në raport me këtë projektligj. Sigurisht që para shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, siç e propozoi relatori në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë, por edhe me të gjithë aktorët dhe faktorët e përfshirë në diskutimin e këtij projektligji, ne do të kemi një

tryezë para se ta kalojmë në seancë plenare për të pasur një projektligj që vendos në balancë ekuilibrat kushtetues, pra respektimin kushtetues të të drejtave themelore të njeriut, por edhe interesin publik që, siç e parashtrori ministria ka të bëjë me vendosjen në një regjim të posaçëm të elementeve kriminale me rrezikshmëri të madhe shoqërore të dënuar nga gjykata.

E bëra këtë sqarim, sepse pyetjet e kolegut Braho shkojnë në këtë drejtim nëse përfaqësuesit e institucioneve janë shprehur në lidhje me projektligjin. Në fakt, ka disa mendime, të cilat një pjesë i ka dorëzuar me shkrim pjesa tjetër pret që në ditët në vazhdim t'i depozitojnë.

Përfaqësuesja e ministrisë a ka ndonjë sqarim?

Etilda Gjonaj - Një sqarim të shkurtër në lidhje me pyetjet e zotit Braho. Sa i përket vlerësimit të nismës edhe neve na ka ardhur një shkresë nga Avokati i Popullit, edhe pse është marrë kjo iniciativë për vendosjen e këtij regjimi me të drejta të kufizuara brenda regjimit të sigurisë së lartë.

Ne nuk jemi njohur ende me komentet që ka sjellë EURALIUS-i dhe Prokuroria e Përgjithshme. Besoj se sot do të njihemi. Çdo lloj sugjerimi që përmirëson projektpropozimin është, gjithashtu, me rëndësi dhe i jep vlerë të shtuar asaj çfarë ne duam të zbatojmë brenda sistemit penitenciar, duke marrë në konsideratë edhe një sërë masash të tjera. Kështu që na ndihmojnë edhe ne komentet dhe sugjerimet që mund të kenë partnerët ose institucionet e tjera, të cilat janë ligjzbatuese, ose ekzekutuese të këtyre vendimeve.

Ulsi Manja- Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Pra, siç e propozoi relatori ne sot do ta votojmë vetëm në parim këtë projektligj, ndërsa shqyrtimi dhe miratimi nën për nën do të bëhet në një seancë tjetër pasi të kemi administruar si komision edhe komentet ose opinionet e institucioneve.

Do të doja të bëja edhe dy sqarime për nismën: siç e tha ministria, bëhet fjalë për vendosjen në një regjim të posaçëm të të gjithë personave të dënuar për format e veçanta të bashkëpunimit në krim. Pra, rrethin e këtyre subjekteve e ka përcaktuar neni 28 i Kodit Penal dhe i referohet organizatës kriminale, organizatës terroriste, grupit të strukturuar kriminal dhe bandës së armatosur. Është e gjithë kjo kategori personash të dënuar për format e veçanta të bashkëpunimit në krim dhe që sipas vendimit të gjykatës janë të vendosur në një regjim vuajtje dënimi të veçantë. Projektligji synon kufizimin e disa të drejtave të këtyre të dënuarve për këtë grup veprash. Pra, themi që këta persona janë duke vuajtur dënimin në burgjet e sigurisë së lartë si edhe të paraburgosurit për këtë grup veprash. Unë bashkohem me mendimin e kolegëve juristë në këtë komision, edhe të ministres së Drejtësisë që u tregua e hapur për çdo sugjerim

dhe koment që i shton vlerën këtij projektligji, i cili është delikat në kuptimin e ndarjes së vijës së hollë në mes garancive kushtetuese dhe interesit publik. Këtu kam parasysh rendin dhe sigurinë publike.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord me votimin në parim të projektligjit? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr 8328 data 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të ndryshuar”.

Dua të sjell në vëmendjen e relatorit por edhe të këshilltares së komisionit që po punojnë me këtë projektligj që gjatë këtyre ditëve deri në caktimin e seancës për shqyrtimin dhe miratimin nen për nen, të administrojnë të gjitha komentet dhe sugjerimet që do të vijnë për këtë projektligj nga Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, EURALIUS-i, OPDAT-i , si edhe nga aktorë dhe faktorë të tjerë, ose deputetë që duan të bëjnë sugjerime dhe komente në lidhje me këtë projektligj. Gjithashtu do të administrohet mendimi i Komisionit të Sigurisë si komision për dhënie mendimi para se ta kalojë te Komisioni i Ligjeve.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar.

6. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar”.

7. Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Madalena Koja- juriste pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri

Xhoana Licka -përfaqësuese nga Agjencia e Prokurimit Publik

Albana Shkurta- Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shtylla- specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ardiana Jaku –Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj- Nëndrejto e Shërbimit Social Shtetëror

Miranda Pashaj -Drejto e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike

Adrian Kamenica – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Ulsi Manja - Vazhdojmë me rendin e ditës: projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93 të vitit 2015 për turizmin”, i ndryshuar; projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” për të cilin jemi komision për dhënie mendimi, si edhe me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar”, për të cilin jemi komision përgjegjës.

Të tria projektligjet kanë lidhje me njëri- tjetrin, sepse ndryshimi që sugjerohet prek të tria këto projektligje.

Relator është deputeti Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Kryeministria, zonja Madalena Koja, juriste pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë, zonja Alma Dino përfaqësuese e Departamentit Juridik të Agjencisë së Prokurimit Publik, dhe zonja Xhoana Liçka përfaqësuese po nga Agjencia e Prokurimit Publik; nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është paraqitur, zëvendësministria zonja Albana Shkurta dhe zonja Eralda Shtylla, specialiste; nga Ministria e Turizmit sekretari i Përgjithshëm i ministrisë.

Duke qenë se janë disa institucione që janë të përfshirë në diskutimin e këtyre tri projektligjeve të rëndësishme, kush nga ju do të bëjë një prezantim për kolegët dhe opinionin publik?

Dakord.

Fjalën e ka Madalena Koja, juriste pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri.

Madalena Koja- Faleminderit!

Sot vijmë me një paketë ndryshimesh për 4 projektligje, konkretisht në ligjin për prokurimin publik, ndryshim në ligjin për turizmin, ndryshimin në ligjin për ndihmën shtetërore, si dhe ndryshimin në ligjin për investimet strategjike.

Të katër amendimet janë në bashkërendim me njëri- tjetrin dhe janë në përgjigje të nismës së Kryeministrit për një luftë pa kompromis ndaj krimit të organizuar.

Në këtë kuadër projektligjet parashikojnë përjashtimin nga përfitimi i fondeve publike, jo vetëm të operatorëve, të cilët janë të dënuar me një vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të parashikuara në ligj, por edhe në rastin kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë për një sërë veprash penale është anëtar, aksioner, administrator, ose përfaqësues ligjor i një operatori, i cili konkurren në një garë për të përfituar një kontratë publike.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesja e Ministrisë së Financave zonja Shkurta.

Albana Shkurta- Në fakt, përmbledhja që u bë nga përfaqësuesja nga Kryeministria është në përputhje të plotë edhe me qëndrimin që ka ministria jonë sa u përket dy projektligjeve për investimet strategjike si edhe për ndihmën shtetërore. Kjo do të thotë që çdo lloj incentivi që parashikohet për biznesin ose në mbështetje të sipërmarrjes duhet, në fakt, që t'u ofrohet atyre që janë duke vepruar në përputhje me ligjin dhe që nuk kanë pasur precedentë ose lidhje me organizatat kriminale. Kështu që edhe ne jemi dakord me përfaqësuesen nga Kryeministria.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit.

Adrian Kamenica – Aktualisht ligji i turizmit parashikon një sërë incentivash sidomos fiskale për investitorë potencialë në fushën e turizmit. Ne mendojmë se ky amendim që i bëhet ligjit është shumë i rëndësishëm në këtë moment. Kemi oferta shumë serioze të investitorëve të huaj dhe vendas për të përfituar prej këtyre incentivave, prandaj ne mendojmë se përjashtimi i të gjithë këtyre kategorive të biznesmenëve nuk meritojnë t'i përfitojnë këto incentiva janë në momentin e duhur dhe ashtu siç duhet, në bashkërendim me të gjitha ndryshimet.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Në kuadër të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar Këshilli i Ministrave na paraqet sot katër projektligje, nga të cilat vetëm për projektligjin për prokurimet publike jemi komision përgjegjës, ndërsa për projektligjet e tjera jemi komision për dhënie mendimi. Qëllimi dhe përmbajtja pothuajse është e njëjtë për të gjitha projektligjet dhe ka të bëjë me investitorët menaxhues, investitorët strategjikë, pra të gjithë ata që janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e disa veprave të rënda penale, por edhe për personat e dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë që janë anëtarë të organeve administrative, drejtues ose mbikëqyrës që kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse dhe kontrolluese brenda investitorit ose operatorit menaxhues.

Ne kemi disa propozime për të gjitha projektligjet dhe kur të vijë puna e diskutimit të ligjit nen për nen, do t'i shqyrtojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Ju përgëzoj ju si përfaqësues të qeverisë dhe qeverinë për këtë nismë që keni sjellë, sepse në kuadrin e gjithë strategjisë dhe luftës konkrete kundër krimit të organizuar kjo është një masë mëse e nevojshme. Pyetja që kam ka të bëjë me faktin, me aq sa kam dijani, në bazë të legjislacionit ekzistues sot në Shqipëri ka ndalesa sa i takon pjesëmarrjes në procedurat konkurruese të subjekteve që kanë lidhje me krimin. Pra, ka më shumë se 2 vjet që përjashtohen subjekte, të cilat kanë vendime të formës së prerë për vepra penale të kryera. Me këtë iniciativë që keni sjellë në paketë për ndërhyrjen në 4 ligjet zgjeroni rrethin e subjekteve apo zgjeroni rrethin e veprave penale, apo të dyja së bashku? Ku konkretisht? Është ashpërsuar lufta ndaj veprimeve apo ndaj subjekteve?

Kjo është mjaft e rëndësishme, sepse përveç faktit të punës që po realizohet paralelisht nga të gjitha institucionet ligjzbatuese të vendit për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, është shumë e rëndësishme po ashtu që ky vullnet i shprehur të jetë i qartë nga të gjithë se ku konkretisht do të bëhet ndërhyrja në këto katër ligje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja Koja.

Madalena Koja – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, pyetja është shumë e drejtë, prandaj më lejoni t'ju sqaroj faktin se kemi të bëjmë me një përcaktim më të qartë të veprave penale, të cilat janë parashikuar dhe referohen në Kodin tonë Penal, por, gjithashtu, ndryshimet vijnë edhe në frymën e direktivës së Bashkimit Europian dhe me kërkesë të tyre për përafrim dhe qasje sa më të plotë me direktivën përkatëse për prokurimin publik.

Kjo do të thotë që për këtë pjesë neni ekzistues, të cilit ju iu referuat me të drejtë, nuk ishte në përputhje të plotë me direktivën e Bashkimit Europian jo vetëm sa i takon llojit të figurave të veprave penale, por ndryshimi konsiston edhe te subjekti. Pra, kjo do të thotë që jo vetëm personi juridik, pra operatori, ndaj të cilit ka një vendim të formës së prerë, por edhe personat, të cilët kanë fuqi vendimmarrëse brenda operatorit, i cili mund të jetë një administrator, një aksioner, një përfaqësues ligjor dhe në raste të tilla ligji dhe parashikimi shkon përtej. Pra, këta persona do të jenë të përjashtuar nga e drejta për të konkurruar, për të përfituar fonde publike apo kontrata publike. Ky tashmë është një kriter kualifikues.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Koja!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim për katër projektligjet.

Vazhdojmë me projektligjin e parë “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar””. Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar””.

Zoti Leka, a të kalojmë nen për nen për secilin nga projektligjet?

Edmond Leka – Po.

Ulsi Manja – Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji. Zoti Leka, ju lutem, më ndiqni për të bërë ndërhyrjet dhe komentet tuaja!

Neni 1.

Edmond Leka – Sa i takon nenit 1, pika 2 e kreut 6, paragrafi numërohet me numrin 1 dhe më pas shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje.

Në pikën 2 thuhet: “Përfshihet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun 6 të këtij ligji çdo investitor dhe operator menaxhues kur ka të dhëna ose ka qenë...”. Kjo “kur ka të dhëna” duhet që këto të dhëna të jenë.

Gjithashtu, propozojmë që në listimin e veprave penale duhet të merret në konsideratë kategorizimi i veprave penale sipas Kodit Penal. Për këtë arsye germat “d” dhe “ë” mund të riformulohen si vijon:

Germa “d” të themi: “Vepra me qëllime terroriste”. Në germën “ë”: “Shfrytëzimi i punës së të miturve”. Pra, germa “ë” është e formuluar në këtë mënyrë: “Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore”, të bëhet “shfrytëzimi i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore”.

Ulsi Manja – Zoti Leka, ju propozoni që në nenin 1 “Listimi i veprave penale” t’i referohet saktësisht përcaktimeve që bën Kodi Penal. Kjo më duket një vërejtje e drejtë, prandaj këshilltarët ta mbajnë në konsideratë që në listimin e veprave t’i referohen saktësisht përcaktimeve që bën Kodi Penal.

Edmond Leka – Zoti kryetar, nuk mund të shkruhet “kur ka të dhëna”...

Ulsi Manja – Kjo është çështje tjetër. Për shembull, germa “h”: “Puna e fëmijëve”. Sa i takon punës së fëmijëve do të duhet t’i referohesh saktësisht se çfarë përcakton Kodi Penal lidhur me punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve.

A ka sugjerime të tjera për nenin 1?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Në pikën 3, bëhet një propozim ku operatori apo investitori menaxhues do të paraqesë një vërtetim nga dosja gjyqësore. Këtë pjesë nuk e kuptoj. Çfarë vërtetimi duhet të paraqesë

nga dosja gjyqësore? Mendoj se dokumenti që duhet të paraqitet duhet të specifikohet sa i takon dosjes gjyqësore dhe se çfarë vërtetimi duhet, ka dosje apo ka procedim penal? Mendoj që kjo gjë duhet të specifikohet konkretisht se çfarë kërkohet të paraqitet. E para.

Nëse më lejoni t'i rikthehem termit “kur ka të dhëna”, mendoj se kjo duhet specifikuar. Ne nuk mund ta lëmë në mendimin e organit që ka aktet në dorë për të vërtetuar se ka të dhëna apo jo. Pra, duhet një dokument që vërteton se shtetasi është në ndjekje penale, apo jo, është i dënuar, apo jo, por nuk mund të themi “kur ka të dhëna”. Këto të dhëna mund të jenë edhe nëpërmjet informacioneve ku dikush mund të ketë thënë që ky person është i dënuar dhe subjekti mendon se duhet përjashtuar nga mbështetja dhe lehtësimi....

(Diskutime pa mikrofon)

Në këto kushte mendoj se duhet një dokument specifik për të vërtetuar nëse ka qenë i dënuar apo është i dënuar, por jo nëpërmjet të dhënave, sepse mendoj se në këtë rast lihet vend për abuzim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, për sugjerimin!

Ju lutem, lexojeni mirë nenin 1, sepse nuk flitet për të dhëna në fazë hetimi, por flitet nëse ka të dhëna që është apo ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në çdo rast kërkohet vendimi gjyqësor i formës së prerë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse ka të dhëna që një investitor apo operator menaxhues është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, sigurisht deri në administrimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë ky nuk mund të jetë...

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet të qartësohet që bëhet fjalë për vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Ju lutem, përfaqësuesit e Kryeministrit, çfarë keni pasur parasysh kur keni thënë “kur ka të dhëna”? A mund të na e specifikoni teknikisht një subjekt që ka aplikuar për të marrë pjesë në një tenderim publik? Ju keni të dhëna që ky investitor apo operator është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, si veproni ju konkretisht? Si do të zbatohet praktikisht kjo?

Madalena Koja – Komenti i paraqitur në lidhje me shprehjen “kur ka të dhëna” mund të riformulohet dhe besoj se kjo nuk e cenon, por sjell qartësi në këtë formë: “Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në kreun 6 të këtij ligji çdo investitor, operator menaxhues, i cili është ose ka qenë i dënuar”.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju sugjeroni të hiqet fjala “kur ka të dhëna” dhe të thuhet: “Çdo investitor, operator menaxhues, i cili është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës...”

Madalena Koja – Duhet fjala “nëse është ose ka qenë i dënuar”...

Ulsi Manja - ... nëse është ose ka qenë i dënuar”

A jeni dakord që fjala “kur ka të dhëna” të zëvendësohet me fjalën “nëse”?

Relatori?

Edmond Leka - Dakord.

Ulsi Manja - A ka sugjerime të tjera?

Për nenin 1, pika 3 kishte një sugjerim. Ju lutem, të reflektohet në pikën 3 të nenit 1, jo vërtetim nga dosja gjyqësore, sepse Kodi i Procedurës Penale kur i referohet Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, përcakton dëshminë e penaltetit si dokument dhe pastaj vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria është vërtetim. Ju keni thënë: “Investitori, operatori menaxhues duhet të paraqesë vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni”.

Te pika 3, duhet të saktësohet natyra e dokumentit që kërkohet.

A ka sugjerime të tjera për nenin 1? Jo.

Hedhim në votim nenin 1 me këto specifikime. Sa i takon pikës 2, këshilltarët të kenë vëmendjen, po ashtu relatori dhe përfaqësuesit e ministrisë. Listimi i veprave penale që përmenden në pikën 2 të nenit 1 të bëhet duke iu referuar saktësisht përcaktimeve që bën Kodi Penal për këtë grup veprash. Në pikën 3 të këtij neni të specifikohet dokumenti që kërkohet nga investitori apo operatori në rastin konkret.

Sigurisht sugjerimet e bëra nga kolegu Leka dhe zonja Xhina, për zëvendësimin e fjalës “kur ka të dhëna” me fjalën “nëse”.

A jeni dakord me nenin 1 me specifikimet që thamë? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi e ligjit”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar””.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Madalena Koja- juriste pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri

Xhoana Licka -përfaqësuese nga Agjencia e Prokurimit Publik

Albana Shkurta- Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shtylla- specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ardiana Jaku –Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj- Nëndrejtoare e Shërbimit Social Shtetëror

Miranda Pashaj -Drejtoare e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike

Adrian Kamenica – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 55 të vitit 2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”. Është i njëjti përcaktim si në ligjin për turizmin.

Fjalën e ka relatori.

Edmond Leka – Kemi një propozim, që në pikën e parë, fjalia e kësaj pike, me qëllim që të jetë e qartë dhe në përputhje me terminologjinë e përdorur, të riformulohet si vijon:...

Ulsi Manja - Më falni, nëse janë të njëjta sugjerimet si te projektligji i turizmit...

Edmond Leka – Te puna e fëmijëve dhe të dhënat, jemi dakord, por pika e parë, propozojmë të riformulohet në këtë mënyrë: “Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit “Investim ose investitorë strategjikë”, procedurë e asistuar, apo “Investim, investitorë strategjikë”, procedurë e veçantë, kur ka të dhëna se është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale”.

Ulsi Manja - Zoti Leka, që të jemi të qartë, në të katërt projektligjet do të reflektohet i njëjti ndryshim që propozuam. Fjalët “kur ka të dhëna”, zëvendësohen me fjalën “nëse” dhe listimi i veprave penale do të bëhet duke iu referuar përcaktimit që bën Kodi Penal. Kjo vlen për të katër projektligjet.

Edmond Leka – Të tjerat pastaj, ngelen me propozimet që bëmë edhe në ligjin për turizmin.

Ulsi Manja – Pra, ju keni një riformulim për nenin 1, ku sugjeroni...

Ju lutem, riformuloheni edhe një herë saktësisht përmbajtjen e pikës 1/1.

Edmond Leka – Propozimi ynë është që të riformulohet në këtë mënyrë: “Subjekti përjashtohet nga përfitimi i statusit “Investim ose investitorë strategjikë”, procedurë e asistuar, apo “Investim, investitorë strategjikë”, procedurë e veçantë, nëse ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale”.

Ulsi Manja – Jeni dakord?

Po, Ministria e Financave.

Albana Shkurta – Në fakt, propozimi për ndryshim është i drejtë, sepse edhe në ligjin nr. 55, përcaktimi për dy llojet e mënyrave sesi një subjekt mund të asistohet nga shteti, janë dy procedura të ndryshme që varen nga madhësia e investimit, njëra prej tyre është procedurë e veçantë dhe tjetra është e asistuar. Ndaj, propozimi është i drejtë dhe gjemi dakord.

Ulsi Manja – Faleminderit!

E hedhim në votim nenin 1 me propozimin e bërë për riformulim nga zoti Leka dhe me sugjerimet e bëra me dy ndryshimet që thamë, fjalët “kur ka të dhëna” me “nëse” dhe listimin e veprave penale sipas përcaktimit të Kodit Penal.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2 “Hyrja në fuqi”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Madalena Koja - juriste në Departamentin Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri

Alma Dino - përfaqësuese nga Departamenti Juridik i Agjencisë së Prokurimit Publik

Xhoana Licka - përfaqësuese nga Agjencia e Prokurimit Publik

Albana Shkurta - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shtylla - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ardiana Jaku - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj - nëndrejtoreshë e Shërbimit Social Shtetëror

Antoneta Njehrrëna - Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj - Drejtore e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike

Ulsi Manja - Kalojmë te projektligji tjetër “Për disa ndryshime në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”. Ne jemi komision përgjegjës.

Zotit Leka, përfaqësuesve të qeverisë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave do t’ju lutesha të ndiqni nenet, nëse keni ndërhyrje apo komente.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik, të ndryshuar”. Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim.

Vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi për t’i kaluar seancës plenare për votim.

Sekretare
Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Edlira Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Madalena Koja - juriste në Departamentin Rregullator dhe Përputhshmërisë në Kryeministri

Alma Dino - përfaqësuese nga Departamenti Juridik i Agjencisë së Prokurimit Publik

Xhoana Licka - përfaqësuese nga Agjencia e Prokurimit Publik

Albana Shkurta - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Eralda Shtylla - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ardiana Jaku - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj - nëndrejtoreshë e Shërbimit Social Shtetëror

Antoneta Njehrrëna - Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj - Drejtore e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike

Ulsi Manja – Kalojmë te projektligji tjetër “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim.

Vazhdojmë me shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Zoti Leka ka kërkuar fjalën.

Edmond Leka – Kemi një propozim te fjalia e parë e pikës 1, me qëllim që të jetë më e qartë, kemi bërë formulimin që vijon: “Subjekti përjashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore kur ka të dhëna se është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale”.

Duhet të ndryshojmë fjalinë “kur ka të dhëna”.

Ulsi Manja – Këtë e thamë që në projektligjin e parë. Në të katërt ligjet, formulimi “kur ka të dhëna”, zëvendësohet me fjalën “nëse” dhe listimi i veprave penale në të katërt projektligjet do të bëhet sipas përcaktimit të Kodit Penal.

Ka sugjerime të tjera? Nuk ka!

Atëherë hedhim në votim nenin 1 me reflektimin e ndryshimeve që propozohen. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 . Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”.

Me miratimin e këtij projektligji, e mbyllim paketën prej katër projektligjesh, që u sugjeruan për t’u ndryshuar nga qeveria.

Faleminderit për prezencën zonjës Koja, zonjës Shkurta, stafit të përfaqësuesve të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit dhe stafeve që i shoqërojnë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar"

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ardiana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lida Leskaj - nëndrejtoreshë e shërbimit Social Shtetëror

Antoneta Njehrrëna - Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Eneida Capo - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Miranda Pashaj - Drejtore e Kontrollit të Ndihmës Ekonomike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ulsi Manja - Kalojmë në projektligjin e fundit për ditën e sotme "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar", nismë e deputetit Vullnet Sinaj. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore e këtij projektligji është kolegja Bushka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zonja Ardiana Jaku, zëvendësministre, dhe stafi i ministrisë që e shoqëron.

Zoti Sinaj, mirë se keni ardhur në komision!

Faleminderit për prezencën, por edhe për nismën që keni ndërmarrë!

Në këtë komision, tashmë është bërë traditë shqyrtimi i nismave të deputetëve. Kryesisht kanë qenë nisma të kolegëve të mi të Komisionit të Ligjeve, por është hera e dytë në këtë sesion parlamentar që shqyrtojmë nisma të kolegëve tanë deputetë. Kishim nismën e kolegut Erion Braçe para pak kohësh, tani kemi një nismë interesante që propozohet nga ju, zoti Sinaj.

Faleminderit edhe një herë! Ju lutem na bëni një prezantim të nismës për kolegët, por edhe për opinionin publik.

Fjala është për ju.

Vullnet Sinaj - Edhe unë ju falënderoj ju, si kryetar, dhe komisionin për vlerësimin e nismës që kam ndërmarrë.

Kjo nismë vjen si rezultat i një ngjarjeje që ka ndodhur në Bashkinë e Selenicës dhe unë mendoj që, siç ka ndodhur atje, mund të ndodhë edhe në bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë, lidhur me ndihmën ekonomike që u jepet njerëzve dhe familjeve në nevojë.

Në muajin shtator-tetor të këtij viti pati një problem. Këshilli bashkiak nuk u mbledh këtë periudhë e për pasojë nuk iu dha ndihma ekonomike këtyre njerëzve e familjeve në nevojë. Për këtë arsye, si deputet i zonës dhe duke menduar që ky problem mund të shtrihet edhe në bashkitë e tjera të vendit, mendimi im është që të mos i lëmë këto familje të vuajnë pasojat e politikës apo indiferentizmit të bashkive, që, për arsye të ndryshme këshillat bashkiakë, nuk mbledhen.

Bëhet fjalë për ndryshime të ligjit nr. 93/55, 10.03.2005. Pasi e studiova ligjin, vura re se ky ligj është ndryshuar më pas me ligjin nr. 44 të vitit 2016 dhe me ndryshimet që ka pësuar u është hequr e drejta bashkive dhe këshillave bashkiakë për të vendosur se cilët do të jenë personat që do të marrin ndihmën ekonomike. Në bazë të investimit të Bankës Botërore dhe Regjistrimit Kombëtar Elektronik kjo i ka kaluar Shërbimit Social Shtetëror dhe drejtorive rajonale të këtij shërbimi. Mirëpo, ky ligj ka disa kufizime dhe unë do të thosha se është pikërisht neni 29, pika 1 që është ende në fuqi në këtë ligj, i cili thotë: "Këshilli bashkiak merr

vendim për propozimin që familja apo individi në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe parashikon masën përkatëse për përfitim. Ky vendim i përcillet menjëherë zyrtarisht Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror”. Unë propozoj që kjo të shfuqizohet, sepse këshilli bashkiak apo bashkia tashmë nuk ka të drejtë të përcaktojë vlerën e ndihmës ekonomike. Mendoj se do të ishte më mirë që me këtë pikë të merrej struktura e Shërbimit Social që është në bashki.

Shfuqizimi i kësaj pike të këtij neni, sjell edhe disa pasoja të tjera në ligj që janë: në nenin 29, pika 1 ku bëhet fjalë për përgjegjësitë e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat janë të detyruara të presin këtë vendim të këshillit bashkiak. Tashmë nuk kemi më nevojë për vendimin e Këshillit Bashkiak, kur bëhet fjalë për një listë të përgatitur nga punonjësi i Shërbimit Social Shtetëror, në njësinë administrative. Pra, është thjesht një listë që do t’i kalojë shërbimit social dhe nuk është më e nevojshme që të kemi një vendim si ai i mëparshmi. Këto janë pasoja të ligjit të mëparshëm, ndaj propozoj që ky ligj të shfuqizohet për t’ia lehtësuar rrugën Shërbimit Social Shtetëror, i cili do t’u vijë menjëherë në ndihmë këtyre familjeve dhe individëve në nevojë pas këtyre ndryshimeve. Duke u mbështetur te Regjistri Kombëtar Elektronik, Shërbimi Social Shtetëror bën vlerësimet për çdo individ dhe e ka shumë kollaj për t’ua kaluar këto vlerësime bashkive apo njërive administrative në zonë.

Duke e zhvlerësuar këtë, në këtë rast mendoj që pika 1 e nenit 27, ku në këtë rast, njësitë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të mos jenë të detyruara të presin vendimin e këshillit bashkiak, por të presin një shkresë përcjellëse nga struktura përgjegjëse e shërbimit bashkiak apo nga njësitë administrative.

Po kështu, preket edhe neni 30, pika 1, e cila ka të bëjë me detyrat që ka struktura përgjegjëse e Shërbimit Social në bashki. Ende vazhdojmë me nenin 2 ku thuhet: “Hartoni projektvendimin për familjet dhe individët në nevojë dhe për llogari të fondit dhe mbulimit të tyre”. Nuk përllogarit më fonde dhe nuk merr më në besim familje shërbimi social në bashki. Këto kompetenca me ligjin e ri nr. 44/2016 i kanë kaluar Shërbimi Social Shtetëror, kështu që këto janë pika të mbetura nga ligji i mëparshëm, të cilat duhet të ndryshohen. Unë propozoj të bëhet: “Struktura përgjegjëse e Shërbimit Social në bashki përcjell në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet dhe individët në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike”.

Po kështu, propozoj të shfuqizohet edhe pika 2 e këtij neni, sepse kjo ka të bëjë me atë që nuk kanë të drejtë të paraqesin në këshillin bashkiak propozimin për projektvendim, sepse preket neni 31 pika 1, ku thuhet që administratorët shoqërorë në bashki ose njësi kanë për detyrë të kontribuojnë për procesin e hartimit të projektvendimeve për propozimin që

familja ose individi në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe listën e personave me aftësi të kufizuar. Në këtë rast duhet t'ua heqim të drejtën për ndihmën ekonomike dhe t'ua lëmë vetëm personave me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu, kjo lidhet edhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 955, të datës 17.12.2016 tek i cili do të duhet të ndryshojmë pikat 6 dhe 7, ku kushtëzohet vendimmarrja e shërbimit social shtetëror nga ardhja e propozimit të këshillit bashkiak.

Së fundi, doja t'ju thosha, të nderuar kolegë, se sjellim aq shqetësime atyre familjeve që kanë shumë nevojë për atë ndihmë ekonomike që ua jep ligji thjesht vetëm për një vendim të këshillit bashkiak, që tashmë është rrëzuar. Për këtë arsye mora këtë nismë për të bërë këtë ndryshim në ligj.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Sinaj!

Fjalën e ka përfaqësuesja e ministrisë, zonja Jaku.

Adriana Jaku - Faleminderit!

Faleminderit deputetit për nismën e sjellë.

Do të doja të bëja me dije se me urdhër të ministrit ne kemi ngritur një grup pune, i cili në datën 1 nëntor të këtij viti ka përfunduar së shkruari projektligjin e ri për mbrojtjen sociale.

Çfarë dua të them me këtë? Me këtë dua të them se ligji nr. 9355, i vitit 2005 është amenduar 7 herë dhe si rezultat i kësaj ka disa mbivendosje. Në mënyrë që të shkojmë në një linjë ne menduam dhe kemi hartuar një projektligj për mbrojtjen sociale, i cili përcakton 3 programet kryesore të mbrojtjes sociale, që janë: ndihma ekonomike, aftësia e kufizuar dhe shpërblimi për lindjen e bebeve. Ne aktualisht po bëjmë konsultimet publike. Projektligji i ri është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë te hapësira për konsultim publik dhe nga ana tjetër në ministri kemi thirrur për konsultim publik grupet e interesit. Do të doja këtu të thosha, gjithashtu, se shqetësimi që deputeti sjell është i përcaktuar në këtë projektligj të ri dhe është në nenin 20 ku këshillave bashkiakë iu përcaktohet roli i tyre, por duke përjashtuar rolin që ata kishin më përpara në konfirmimin e listës të personave të familjeve aplikuese për ndihmën ekonomike. Tashmë këshilli bashkiak vetëm miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familje që nuk janë shpallur fituese, pra për shpërndarjen e fondit 6% që ministria u alokon bashkive për familjet që nuk mund të marrin ndihmë ekonomike. Si rezultat i këtij ndryshimi reflektohet, në fakt, ndryshim edhe në nenet 21 dhe 22. Kështu që ne jemi në të njëjtën linjë dhe synojmë që brenda muajit nëntor të fillojmë procesin e miratimit të këtij projektligji.

Ulsi Manja – Po, faleminderit zonja zëvendësministre.

Zonja Bushka ka fjalën.

Klotilda Bushka- Faleminderit!

Unë si ish-anëtare e këshillit bashkiak të Tiranës jua kuptoj shqetësimin ju dhe të gjithë qytetarëve. të cilët mbeten peng i mosmarrjes së vendimit nga këshilli bashkiak, i cili rëndon familjet në nevojë.

Në fakt, herë pas here është bërë ky diskutim dhe është thënë që duhet një ndryshim në ligj. Kjo nismë, në fakt, është një shqetësim i ngritur nga bashkitë dhe ministria që mbulon çështjet sociale. Prandaj më vjen mirë sot që dëgjoj zëvendësministren që kjo punë ka përparuar më hartim të një projektligji kuadër, i cili do të trajtojë për zgjidhje edhe këtë shqetësim.

Në Bashkinë e Tiranës sot ndihma që përfitohet në bazë të këtij ligji për të cilin kërkon ndryshim zoti Sinaj mbetet peng i mospjesëmarrjes të kolegëve këshilltarë nga ana e opozitës prej më se 8 muajsh. Janë detyruar sot të bëjnë mbase edhe vendime urgjente pa pritur të mblidhen të gjithë anëtarët e këshillit, sepse bëhet fjalë për bukën e gojës së njerëzve. Kështu që ndërgjegjësimi që vjen nga deputetët, por edhe nga ministria që ka ngritur një grup pune tregon se problemi është në rrugën e zgjidhjes. Sugjeroj të shqyrtohet paralelisht nisma me propozimin që ka sjellë zoti Sina, sepse duhen parë nëse janë në të njëjtën linjë logjike dhe kanë të njëjtin qëllim, për t'i unifikuar. Unë mendoj që sot të prezantohemi me nismën dhe sa i takon miratimit në parim ta diskutojmë së bashku me nismën që do të vijë edhe nga qeveria për ligjin kuadër.

Ulsi Manja- Po, faleminderit, zonja Bushka!

Unë kam një pyetje: në ç'fazë është projektligji që ju propozoni, zonja zëvendësministre dhe kur mund të vijë ky projektligj në Kuvend?

Adriana Jaku – Aktualisht jemi në fazën e konsultimeve, po presim mendime nga grupet e interesit, pa diskutim edhe nga institucionet e përfshira. Ne mendojmë se brenda dhjetorit të këtij viti do të jetë për aprovim.

Ulsi Manja – Pra, projektligji do të jetë i depozituar në Kuvend brenda dhjetorit.

Vullnet Sina- Mjafton që të zgjidhet problemi. Nuk ka rëndësi se çfarë do të merret parasysh, nisma ime apo projektligji që po bën qeveria. Ligji ekzistues ka edhe probleme të tjera. Shpresoj që ministria përgjegjëse t'i ketë kapur problemet, për shembull siç është problemi i trajtimit të personave me aftësi të kufizuara ose ata që kanë humbur aftësitë për punë, pra ka të bëjë me ata persona që dëmtimi i tyre ka ndodhur në kohën kur nuk kanë pasur sigurime shoqërore. Në këtë moment ligji i ka lënë pa trajtuar këta persona, por nga ana tjetër kemi një ligj për personat e lindur me aftësi të kufizuara, të cilët ligji i merr parasysh. Pra, kemi një handicap të ligjit, i cili nga njëra anë i trajton të gjithë personat me aftësi të kufizuara që kur kanë lindur, nga ana tjetër trajton persona me aftësi të kufizuara që kanë humbur aftësitë

e tyre gjatë punës, por kanë qenë të siguruar, por lë një shtresë të pa trajtuar fare, që janë të aksidentuarit që nuk kanë qenë të siguruar 5 vjetët e fundit para aksidentit. Shpresoj ta merrni parasysh edhe këtë.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Sina!

A ka pyetje?

Xhemal Qefalia- Unë doja të eidentoja faktin që kolegu Sina është kontribuues edhe te Komisioni i Sigurisë dhe ta falënderoja që me nismën e propozuar ka avancuar më shpejt se ministria.

Bledar Çuçi- Faleminderit!

I gjithë shqetësimi i kolegut Sina ekziston. Ka qenë prezent në disa bashki, sidomos kohët e fundit. Në parim mbetem dakord me propozimin e relatores që ta shohim edhe këtë ndryshim në frymën e të gjithë paketës që do të vijë nga qeveria për të rishikuar ligjin për ndihmën ekonomike. Kam një merak që duhet t'ia bëj prezent edhe ministrisë përgjegjëse që po merret me këto ndryshime, nëse një gjë nuk funksionon në administrim ne nuk duhet të gjejmë rrugën më të shkurtër që mendojmë ne se do të funksionojë dhe të heqim dorë nga ndërtimi i të gjithë strukturës publike që buron nga vota e njerëzve.

Shërbimi shoqëror në princip si funksion është i qeverisjes vendore dhe kjo është e përcaktuar në ligjin për vetëqeverisjen vendore, edhe mënyra si bëhet caktohet me ligj. Por nuk duhet të harrojmë që ky është një shërbim që është kompetencë e qeverisjes vendore. Kështu që përgjegjësinë para qytetarëve e ka bashkia. Këtu duhet të ndalemi më konkretisht dhe duhet të themi nëse ky është funksion që do t'ia lëmë këshillit bashkiak, apo kryetarit të bashkisë si një person që zgjidhet nominalisht drejtpërdrejtë nga sistemi mazhoritar. Këtu duhet të ketë kujdes ministria kur të fillojë të ngrëjë këtë skemë të bashkëpunimit midis ministrisë përgjegjëse apo qeverisë që jep para për këtë mision dhe bashkisë për të përcaktuar listën dhe për ta shpërndarë atë. Është një proces delikat që duhet ta ketë parasysh në të gjithë amedimin që do të bëjë për këtë qëllim. Ne kemi bërë një hap para për të aplikuar një skemë që është ngritur në bashkëpunim me Bankën Botërore. Unë nuk e di se çfarë faze është aplikimi i kësaj skeme, por e rëndësishme është që kur ministria të vijë të na paraqesë paketën e ndryshimeve duhet të na sjellë edhe një raport për rezultatin që ka dalë nga aplikimi i skemës së imponuar nga Banka Botërore për të parë nëse ia vlen kjo skemë, funksionon më mirë me këtë skemë apo duhet gjetur një skemë tjetër. Pastaj sigurisht në këtë frymë duhet të bëjmë ndryshimet përkatëse. Duhet mbajtur parasysh se ky është funksion i qeverisjes vendore. Nëse ka këshilltarë të papërgjegjshëm që nuk miratojnë listën dhe nuk vijnë, kjo është detyrë e politikës vendore që të shkojë para elektoratit dhe t'i thotë, ja kush janë njerëzit që ju lënë ju pa ndihmë

sociale. Kështu funksionon demokracia, jo duke ia lënë në dorë një zyrtar të emëruar, sepse mendojmë ne se ai është më i përgjegjshëm. Përgjegjësia fillon nga delegimi i votës. Prandaj vendosen këto raporte. Këto janë vërejtje të përgjithshme për t'iu bashkuar edhe propozimit të relatores që këtë ta shikojmë në frymën e të gjithë amendimeve që do të sjellin për ndryshimin e ligjit.

Ulsi Manja- Unë bashkohem me sugjerimin e bërë nga relatorja. Ne kemi tashmë praktikë të konsoliduar në këtë komision, do të veprojmë siç vepruam me propozimin e kolegut Braçe. Sot kishim prezantimin në parim të kolegut Sinaj, por ne do ta shqyrtojmë në parim dhe nën për nën këtë nismë në momentin që do të na vijë projektligji nga qeveria.

Nëse projektligji i propozuar nga qeveria nuk vjen brenda muajit dhjetor, ne do të shqyrtojmë nismën e kolegut Sinaj edhe pse jemi komision për dhënie mendimi dhe do t'ia përcjellim komisionit përgjegjës për miratim. Pra, unë besoj se jemi dakord në këtë pikë. Sigurisht, nisma është e depozituar në përputhje me të gjithë procedurat parlamentare dhe është në shqyrtim në Komisionin e Ligjeve për dhënie mendimi por ne do të shprehemi për këtë nismë në momentin që do të kemi ligjin e depozituar nga qeveria. Këtu kam besoj edhe miratimin e kolegëve deputetë.

A jeni dakord që nisma e kolegut Sinaj të shqyrtohet në një moment të dytë kur të prezantohet edhe nisma e qeverisë, meqenëse, sipas zëvendësministres, shqetësimi i kolegut Sinaj gjen zgjidhje në projektligjin e ri që pret të depozitohet në Kuvend? Ne nuk kemi arsye që t'i shqyrtojmë të dy nismat e ndara.

Faleminderit, zoti Sinaj! Faleminderit, zonja Jaku!

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Faleminderit!

Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA

